



UNIVERSITETI I TETOVËS  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18, 178/21, 58/24), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, shpallet:

**KONKURS**

**për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore**

- I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2024/2025, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestër veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.
- II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:
  - biografi (CV),
  - vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2024/2025,
  - vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar.
- III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, rr. "29 Nëntor" 1200 Tetovë, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më 20.06. 2025.
- IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komisionit Zgjedhor

